

# BARRIERAT TREGTARE SI MASA MBROJTËSE POLITIKE NË MARRËDHËNIET KOSOVË-SERBI

---



**Ky projekt është i mbështetur nga: Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS)**

**Autore: Violeta Haxholli**

COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI) dhe Fondacioni Konrad Adenauer.

Instituti Demokratik i Kosovës dhe Fondacioni Konrad Adenauer i kanë të gjitha të drejtat e rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0)38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Pikëpamjet e shprehura në këtë punim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer.

# Përmbajtja

---

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>4</b>
-------------------------------	----------

---

<b>HYRJE</b>	<b>5</b>
--------------	----------

---

<b>1. Historiku i marrëdhënieve tregtare Kosovë-Serbi</b>	<b>7</b>
-----------------------------------------------------------	----------

---

1.1 Marrëdhëniet tregtare Kosovë - Serbi pas luftës dhe para pavarësisë së Kosovës.....	8
-----------------------------------------------------------------------------------------	---

1.2 Shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe embargoja tregtare nga ana e Serbisë si masë kundër shtetësisë së Kosovës.....	9
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---

<b>2. Marrëveshjet e dialogut të Brukselit dhe kundërpërgjigjet e Kosovës ndaj masave tregtare të Serbisë</b>	<b>13</b>
---------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------

---

2.1 Vendosja e masave të reciprocitetit ndaj Serbisë për herë të parë në vitin 2011 .....	15
-------------------------------------------------------------------------------------------	----

2.2 Modalitetet e funksionimit në pikë kalimet kufitare me Serbinë. Arritja e Marrëveshjes së IBM-it.....	16
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------	----

2.3 Mbledhja e të hyrave doganore ndryshe nga pikë kalimet kufitare në veri. Krijimi i Fondit Zhvillimor për veriun.....	18
--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----

2.4 Vazhdimi i kontestimit të shtetësisë së Kosovës dhe rikthimi i masave të reciprocitetit ndaj Serbisë në vitin 2015 .....	19
------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----

<b>3. Faza finale e dialogut dhe masat tregtare si mjet për pengimin e shkëmbimit të territoreve</b>	<b>21</b>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------

---

3.1 Vendosja e tarifës 100% ndaj Serbisë si mjet politik.....	22
---------------------------------------------------------------	----

3.2 Rikthimi i reciprocitetit të plotë tregtar ndaj Serbisë .....	25
-------------------------------------------------------------------	----

<b>Përfundim</b>	<b>28</b>
------------------	-----------

---

## Përmbledhje Ekzekutive

Ky punim, i ndarë në tre kapituj ka për qëllim të analizojë natyrën e marrëdhënieve tregtare Kosovë-Serbi dhe aplikimin e barrierave tregtare nga ana e të dyja shteteve, si masa mbrojtëse politike në marrëdhëniet mes tyre. Këto barrierë janë vendosur nga të dyja palët që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe përgjatë zhvillimit të procesit të dialogut Kosovë-Serbi nën ndërmjetësimin e BE-së, proces ky fillimisht teknik e më pas politik e më pas për normalizimin e marrëdhënieve. Përveç impaktit politik, punimi trajton ndikimin e barrierave tregtare në nivelin e shkëmbimeve tregtare mes Kosovës dhe Serbisë. Në të njëjtën kohë trajtohet edhe ndikimi i dinamikave në marrëdhëniet Kosovë-Serbi në marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtar dhe ndikimi i tyre në zhvillimet e brendshme politike në Kosovë.

Në kapitullin e parë punimi trajton historikun e marrëdhënieve tregtare në mes Kosovës dhe Serbisë, duke vënë në pah ndryshimet në natyrën e shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve para dhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Me theks të veçantë, në barrierat e vendosura nga ana e shtetit serb, si mënyrë e kundërshtimit të shtetësisë së Kosovës dhe ndikimin e këtyre barrierave në nivelin e shkëmbimeve tregtare mes Kosovës dhe Serbisë.

Kapitulli i dytë trajton barrierat tregtare të aplikuara nga ana e të dyja shteteve paralel me zhvillimet në kuadër të dialogut të Brukselit. Në kuadër të këtij procesi për herë të parë Kosova kishte aplikuar masat mbrojtëse ndaj Serbisë, si mjet për të shtyrë Serbinë që të pranonte vulën doganore të Kosovës. Ky seksion po ashtu shpjegon se me gjithë përpjekjet e Kosovës për të vendosur një raport formal mes dy shteteve, Serbia kishte vazhduar të mos njihnte dokumentet zyrtare tregtare të Republikës së Kosovës, duke e detyruar Kosovën që të rikthente masat e reciprocitetit. Më tej trajtohet edhe natyra e marrëveshjeve të dialogut në kuadër të procesit teknik dhe politik, të cilat synonin të rregullonin modalitetet e bashkëpunimit Kosovë-Serbia mbi

parimin e qëndrimit të ndryshëm të palëve rreth shtetësisë së Kosovës.

Kapitulli i tretë trajton avancimin e procesit të dialogut Kosovë-Serbi në fazën finale dhe opsionet potenciale për marrëveshjen finale, të cilat rezultuan me rikthimin e masave tregtare ndaj Serbisë nga ana e Kosovës. Vlen të theksohet se për dallim nga Kosova, Serbia nuk kishte ndërprerë aplikimin e barrierave tregtare si masa mbrojtëse që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës. Në këtë seksion trajtohet edhe ndikimi i masave tregtare ndaj Serbisë në marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtar. Në këtë drejtim, shpjegohet se si këto masa të aplikuara nga ana e Kosovës ndaj Serbisë, u bënë pengesë për avancimin e procesit të dialogut dhe e vendosën Kosovën në anë të kundërta me partnerët ndërkombëtarë. Në fund, trajtohet edhe ndikimi i dinamikave në marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtar në zhvillimet e brendshme politike në Kosovë.

## Hyrje

Marrëdhëniet tregtare Kosovë-Serbi janë karakterizuar me aplikimin e barrierave tregtare mes dy shteteve, kryesisht si masa mbrojtëse politike në marrëdhëniet në mes tyre. Serbia ka filluar aplikimin e masave tregtare ndaj Kosovës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, si masë politike për të kundërshtuar shtetësinë e Kosovës. Ndërsa, Kosova ka përdorur masat tregtare ndaj Serbisë për herë të parë në vitin 2011 e më pas edhe në vitin 2015, për të konsoliduar shtetësinë e saj. Në vitin 2018 dhe 2020 Kosova riktheu masat tregtare ndaj Serbisë përmes tarifës 100%, si përgjigje ndaj fushatës ndërkombëtare të Serbisë kundër shtetit të Kosovës. Mirëpo vendosja e kësaj tarife ndërlidhej edhe me procesin e dialogut dhe propozimeve për marrëveshjen finale që cenonin integritetin territorial të Kosovës. Në këtë drejtim masat tregtare janë përdorur nga ana e të dyja shteteve, si mjet për të përçuar mesazhe politike ose për të materializuar qëndrime politike dhe shtetërore. Kështu dinamikat në marrëdhëniet tregtare Kosovë-Serbi në fakt kanë shpërfaqur natyrën e marrëdhënieve politike mes dy shteteve.

Dy faktor kryesor kanë ndikuar në zhvillimet në marrëdhëniet tregtare Kosovë-Serbi, shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe zhvillimet në procesin e dialogut Kosovë-Serbi, proces ky i ndërmjetësuar nga ana e Bashkimit Evropian. Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës ndryshoi natyra e marrëdhënieve tregtare mes Kosovës dhe Serbi, ndryshim ky që u refuzua nga ana e Serbisë. Para shpalljes së pavarësisë, marrëdhëniet tregtare zhvilloheshin mes Serbisë si shtet dhe Kosovës si territor i administruar nga Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara

(UNMIK). Si rezultat edhe në dokumentet tregtare figuronte mbishkrimi UNMIK Kosova dhe ky mision ishte përcaktues dhe zbatues i politikave tregtare të Kosovës.<sup>1</sup> Serbia filloi aplikimin e barrierave tregtare pikërisht kur ndryshuan edhe dokumentet zyrtare tregtare të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë.

Ndërsa, faktori i dytë ishin zhvillimet në procesin e dialogut Kosovë-Serbi që përcaktuan modalitetet e ndërtimit të marrëdhënieve të reja mes Kosovës dhe Serbisë. Dialogu kishte filluar si proces teknik në vitin 2011 për lehtësimin e jetës së qytetarëve, ndërsa në vitin 2012 ky proces ishte shndërruar në proces politik dhe për normalizimin e marrëdhënieve, në kuadër të të cilit u trajtuan edhe çështje të brendshme të Kosovës. Marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi kanë rregulluar modalitetet e bashkëpunimit mes dy shteteve mbi parimin e qëndrimit të ndryshëm të palëve rreth shtetësisë së Kosovës. Përmbajtja dykuptimshme e marrëveshjeve të dialogut i ka mundësuar Serbisë që të zhvillojë marrëdhënie politike e tregtare me Kosovën, pa e njohur shtetësinë e saj.<sup>2</sup> Ndërsa, për Kosovën që të deklarojë pas çdo marrëveshje të dialogut se Serbia e ka njohur Kosovën si shtet i pavarur.

Fillimisht, Kosova kishte tentuar të konsolidonte shtetësinë e saj në marrëdhëniet tregtare me Serbinë, në kuadër të procesit të dialogut, duke detyruar Serbinë që të pranonte vulën doganore të Kosovës.<sup>3</sup> Për të realizuar këtë, Kosova në korrik të vitit 2011 aplikoi për herë të parë masat e reciprocitetit ndaj Serbisë, të cilat zgjatën deri në pranimin e vulës doganore nga ana e Serbisë në shtator të atij viti.

1 International Alert, "Rregullimi i tregtisë përgjatë kufijve të kontestuar: Rastet e Kinës / Tajvanit, Serbisë / Kosovës dhe Qipros", Autor dhe editor: Natalia Mirimanova, prill 2015, fq.42.

2 Analizë e shkurtër e KDI-së, "Dialogu Kosovë – Serbi: Sfidat dhe rruga përpara", mars 2018, fq.14 në <http://www.votaim.org/Public/Article?Dialog=true&Dialog=false&SelectedTab=Publications&SelectedMonthID=&SelectedYear=&publications>

3 Bisedimet për njohjen e vulave doganore filluan në vitin 2011 në Bruksel në kuadër të dialogut teknik mes Kosovës dhe Serbisë. Qëllimi ishte arritja e një marrëveshjeje për njohjen reciproke të vulave doganore mes dy palëve. Marrëveshja për vulat doganore u arrit në shtator të vitit 2011 pasi Serbia pranoi vulën doganore të Kosovës pas masave të reciprocitetit të vendosura nga ana e Kosovës.

Megjithëkëtë, Serbia sërish kishte vazhduar të sfidonte vulën doganore të Kosovës duke përdorur vulat e saj paralele dhe një sërë barrierash tregtare që ndërlidheshin me kundërshtimin e dokumenteve zyrtare të Kosovës.<sup>4</sup>

Kosova nuk i ishte kundërpërgjigjur barrierave të Serbisë deri në vitin 2015 kur kishte vendosur reciprocitet në certifikatat ADR, për transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme, deri në njohjen e tyre nga Serbia. Tre vite pas, opsionet potenciale për një marrëveshje finale mes Kosovës dhe Serbisë që u prezantuan në vitin 2018, e vendosën sërish Kosovën në pozicion defanziv. Kështu për të penguar diskutimet dhe marrëveshjen që mund të cenonte integritetin territorial, Kosova riktheu masat tregtare ndaj Serbisë, me tarifën 100% në vitin 2018,<sup>5</sup> e cila në vitin 2020 u zëvendësua me masa të reciprocitetit.

Masat tregtare të vendosura, pavarësisht një procesi që synoi normalizimin e marrëdhënieve, vunë në pah në fakt vet mangësitë e këtij procesi, ku paralel me dialogun Serbia zhvillonte fushatë kundër shtetit të Kosovës, ndërsa Kosova aplikonte masa tregtare si mjet politik. Masat tregtare ndaj Serbisë ndikuan edhe në luhatjen e marrëdhënieve të Kosovës me partnerët ndërkombëtar, veçanërisht ata amerikan. Sidomos në dy vitet e fundit kishte momente kur dukej se marrëdhëniet me këta të fundit kishin arritur në një pikë kritike.<sup>6</sup> Në përgjithësi presioni ndërkombëtar ndaj Kosovës për të larguar tarifën ishte më i ashpër, në krahasim me presionin e butë ndaj Serbisë për të ndërprerë fushatën kundër shtetësisë së Kosovës.

Mospajtimet me partnerët amerikan, ndikuan edhe në zhvillimet e brendshme politike dhe në raportet mes spektrit politik në Kosovë, duke shkaktuar


kështu edhe përçarje të thella mes tyre. Mungesa e dakordimit për zëvendësimin e tarifës me masa të reciprocitetit ndaj Serbisë në përputhje me kërkesat e partnerëve amerikan, u bë shkas i përplasjeve politike dhe arsye kryesore e rrëzimit të dy qeverive në Kosovë, qeverisë Haradinaj në korrik 2019 dhe qeverisë Kurti në mars 2020. Ndërsa insistimi për mbajtjen e këtyre masave në fuqi nga ideatorët dhe përkrahësit e tyre, ndërlidhej me pengimin e realizimit të opsioneve kontroverse siç u cilësua teza e 'korigjimit të kufijve' për përmbylljen e procesit të dialogut me Serbinë. Pas mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë Kurti, u krijua Qeveria e re e udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti nga rradhët e LDK-së, e cila shfuqizoi vendimet për masat e reciprocitetit, duke i hapur kështu rrugën vazhdimit të procesit të dialogut.<sup>7</sup>

4 Shih raportet e gjendjes së zbatimit të marrëveshjeve të dialogut të Brukselit, të Qeverisë së Kosovës në, <http://www.votaim.org/Public/Dialog/ViewAllReports>

5 Koha Net, "Haradinaj: Taksa po e pengon formalizimin për ndarje", 25 shkurt 2019 në <https://www.koha.net/arberi/147110/haradinaj-taksa-po-e-pengon-formalizimin-per-ndarje/>

6 RTK, "Pas Grenell edhe O'Brien e shpërndan paralajmërimin e senatorit amerikan", 10 mars 2020 në <https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=417186>

7 Shih vendimin e Qeverisë Nr. 03/03, të datës 6 qershor 2020 në, <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/06/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-3-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>



# Historiku i marrëdhënieve tregtare Kosovë-Serbi

---

## 1.1 Marrëdhëniet tregtare Kosovë - Serbi pas luftës dhe para pavarësisë së Kosovës

Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, marrëdhëniet politike dhe tregtare mes Kosovës dhe Serbisë janë zhvilluar në kontekstin ku Kosova administrohej dhe përfaqësohej si territor nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Ky mision i mandatuar nga Rezoluta 1244 e OKB-së<sup>8</sup> ishte autoritet qendror në përcaktimin dhe zbatimin e politikave tregtare të Kosovës duke përfshirë edhe doganën e Kosovës, e krijuar pas luftës si Shërbimi Doganor i UNMIK-ut.

Edhe pse kishte humbur kontrollin e saj mbi territorin e Kosovës, Serbia në aspektin tregtar e konsideronte Kosovën si treg të brendshëm. Në këtë drejtim, pas luftës autoritetet serbe kishin adoptuar edhe aktet administrative të brendshme për të realizuar marrëdhëniet tregtare me Kosovën mbi këtë parim.<sup>9</sup> Mbi parimin e njohjes së Kosovës si territor i veçantë, por jo si shtet i veçantë, Serbia kishte nënshkruar edhe Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), në vitin 2006, pjesë e së cilës u bë Kosova, në emër të së cilës nënshkruer i marrëveshjes ishte UNMIK-u. CEFTA

ishte marrëveshja e parë tregtare mes Kosovës dhe Serbisë. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Serbia e njohu Kosovën si njësi të veçantë doganore, por jo edhe si njësi të pavarur.<sup>10</sup> Marrëveshja e CEFTA-së e cila hyri në fuqi në vitin 2007 ka për qëllim lehtësimin e tregtisë në mes të vendeve nënshkruese si dhe të shërbej si bazë e mirë ligjore për formulimin e politikave të brendshme tregtare.<sup>11</sup>

Që nga viti 2002 e deri në vitin 2007, tregtia e mallrave në mes Kosovës dhe Serbisë zhvillohej lirshëm duke shënuar trend të rritjes së vazhdueshme nga 193,840 milionë Euro importe nga Serbia në vitin 2002, duke arritur vlerën prej 222,534 milionë euro në vitin 2007 (shih tabelën 1.1).<sup>12</sup> Por nga ana tjetër, eksportet e Kosovës në Serbi ishin shumë më të ulëta duke bërë që bilanci tregtar i Kosovës në raport me Serbinë të ishte negativ. Nënshkrimi i marrëveshjes së CEFTA-së ndikoi pozitivisht në rritjen e vlerës së eksporteve të Kosovës në Serbi. Për dallim nga vlera e mallrave që Kosova kishte eksportuar në Serbi në vitin 2002 prej vetëm 4,745 milionë Euro në vit, në vitin 2006 dhe 2007 sasia e eksporteve u rrit në 20 milionë Euro. Por kjo vlerë gjithsesi mbeti tejte e ulët në krahasim me eksportin e Serbisë në Kosovë duke vazhduar trendin e bilancit negativ tregtar të Kosovës në raport me Serbinë.

**TABELA 1.1:** Shkëmbimet tregtare Kosovë-Serbi gjatë periudhës 2002-2007

Nënshkrimi i CEFTA-s

Hyrja në fuqi e CEFTA-s

Viti	2002	2003	2004	2005	2006	2007
<b>Export</b>	4,745,000.00 €	6,754,000.00 €	10,060,000.00 €	8,158,000.00 €	20,910,000.00 €	19,280,000.00 €
<b>Import</b>	193,840,000.00 €	156,410,000.00 €	161,281,000.00 €	152,257,000.00 €	191,053,000.00 €	222,534,000.00 €

BURIMI: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

8 Shih përmbajtjen e Rezolutës 1244 për Kosovën, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara e miratuar me 10 qershor 1999 në, [https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990610\\_SCR1244%281999%29.pdf](https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990610_SCR1244%281999%29.pdf)

9 International Alert, "Rregullimi i tregtisë përgjatë kufijve të kontestuar: Rastet e Kinës / Tajvanit, Serbisë / Kosovës dhe Qipros", Autor dhe editor: Natalia Mirimanova, prill 2015, fq.26.

10 International Alert, "Rregullimi i tregtisë përgjatë kufijve të kontestuar: Rastet e Kinës / Tajvanit, Serbisë / Kosovës dhe Qipros", Autor dhe editor: Natalia Mirimanova, prill 2015, fq.26.

11 Shih më tepër informacione në ueb faqen zyrtare të CEFTA-së në, <https://cefta.int/cefta-parties-2/>

12 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat tregtare 2008, fq.25 në, <https://ask.rks-gov.net/media/2209/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-2008.pdf>





## Marrëveshja e CEFTA-së e cila hyri në fuqi në vitin 2007 ka për qëllim lehtësimin e **tregtisë** në mes të vendeve nënshkruese si dhe të shërbej si bazë e mirë ligjore për formulimin e politikave **të brendshme tregtare**.

Gjatë vitit 2007, importet nga Serbia përbënin 14.1% të importeve të përgjithshme në Kosovë duke e rënditur atë të dytën pas Maqedonisë.<sup>13</sup> Në anën tjetër, Serbia përbënte 11.7% të eksporteve të përgjithshme të Kosovës dhe renditej e treta, pas shteteve të BE-së dhe Shqipërisë.<sup>14</sup>

Megjithatë, në periudhën e pasluftës shumica e mallrave të tregtuar mes Kosovës dhe Serbisë nuk janë regjistruar, sepse autoritetet doganore nuk kontrollonin gjithë tregtinë,<sup>15</sup> për shkak se një pjesë e mallrave po tregtoheshin në atë që quhej 'zona gri'.<sup>16</sup> Edhe pse autoritetet e UNMIK-ut ishin vendosur në pikë kalimete me Serbinë në vitin 2001, ata nuk mblidhnin taksën doganore në importet nga Serbia, por vetëm tatimin në vlerën e shtuar prej 15%.<sup>17</sup> Në këtë drejtim, marrëdhëniet tregtare Kosovë-Serbi, gjatë periudhës nga pas lufta e deri tek shpallja e pavarësisë zhvilloheshin pa barriera tregtare, mirëpo Kosova nuk po realizonte mbledhjen e të hyrave doganore në pikë kalimete me Serbinë.

Serbia filloi aplikimin e barrierave tregtare pas ndryshimit të statusit të Kosovës nga shtet i

administruar nga UNMIK-u, në shtet të pavarur. Pavarësia e Kosovës implikoi ndryshimet të shumta në dokumentet zyrtare të Kosovës duke përfshirë edhe ato tregtare.

### 1.2 Shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe embargoja tregtare nga ana e Serbisë si masë kundër shtetësisë së Kosovës

Me 17 shkurt 2008 Kosova u shpall shtet i pavarur, duke hapur kështu një epokë të re në marrëdhëniet politike e tregtare me Serbinë. Propozimi gjithëpërfshirës i Ahtisaarit për zgjidhjen e statusit të Kosovës, mbi bazën e të cilit ishte shpallur pavarësia e Kosovës nuk ishte pranuar nga ana e Serbisë, e më pas as Kosova si shtet i pavarur. Plani i Ahtisaarit ishte rezultat i negociatave mes Kosovës dhe Serbisë në Vjenë, të cilat zgjatën nga viti 2005 deri në vitin 2007.

Në shenjë të refuzimit të pavarësisë së Kosovës, dy ditë pas shpalljes së pavarësisë pjestarë të komunitetit serb të mbështetur nga Beogradi iu

13 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat tregtare 2007, fq. 5 në, <https://ask.rks-gov.net/media/2207/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-2007.pdf>

14 Po aty, fq. 24.

15 International Alert, "Rregullimi i tregtisë përgjatë kufijve të kontestuar: Rastet e Kinës / Tajvanit, Serbisë / Kosovës dhe Qipros", Autor dhe editor: Natalia Mirimanova, prill 2015, fq.28.

16 Tregtia gri përfshin shkëmbimet tregtare që nuk janë të paligjshme, por të fshehura në mënyrë që të minimizohen taksat dhe detyrimet doganore.

17 Po aty, fq. 43.

vunë zjarrin pikave të kalimit kufitar me Kosovën 1 dhe 31 në Jarinjë dhe Bërnjak.<sup>18</sup> Shtrirja e autoritetit të Kosovës në këto pika kufitare do të mbetet sfidë edhe në vitet pas pavarësisë, për shkak të strukturave paralele të financuara nga shteti i Serbisë. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, marrëdhëniet tregtare Kosovë-Serbi u përkeqësuan njëanshëm. Qasja e Serbisë ndaj Kosovës ndryshoi, ndërsa ajo e Kosovës ndaj Serbisë mbeti e njëjtë, deri në vitin 2011 kur Kosova vendosi masat e reciprocitetit ndaj Serbisë.

Funksionimi i Kosovës si shtet i pavarur nënkuptonte edhe ndryshimet në aspektet e marrëdhënieve me jashtë. Në aspektin tregtar, me 12 dhjetor 2008 Shërbimi Doganor i UNMIK-ut, i cili deri në këtë kohë kishte qenë autoriteti zbatues doganor në Kosovës, u shndërrua në Doganën e Kosovës. Ky tranzicion u mundësua nga Kodi i ri doganor i cili u miratua nga Kuvendi i Kosovës me 11 nëntor 2008.<sup>19</sup> Kjo nënkuptonte që edhe vula doganore me emërtimin "UNMIK" tani ishte zëvendësuar me emërtimin "Dogana e Kosovës". Serbia refuzoi ta njihte vulën e re doganore të Kosovës, duke ndaluar kështu edhe eksportet e Kosovës në Serbi dhe kalimin transit të mallrave nëpër Serbi.<sup>20</sup> Bllokada e Serbisë ndaj mallrave të Kosovës ishte në kundërshtim me frymën e marrëveshjes së tregtisë së lirë CEFTA, pjesë e së cilës ishin të dy shtetet që nga viti 2006.

Qasja e Serbisë vendosi marrëdhënie asimetrike tregtare mes dy shteteve, sepse Serbia po pengonte eksportet e Kosovës në drejtim të saj, ndërsa Kosova lejonte importet nga Serbia pa asnjë pengesë.<sup>21</sup>

Mosnjohja e vulës doganore të Kosovës dhe ndalimi i kalimit transit në Serbi u reflektua edhe në vëllimin tregtar mes dy shteteve.<sup>22</sup> Përqindja e eksporteve të Kosovës në Serbi u përgjysmua në vitin 2008, ndërsa vlera e importeve nga Serbia pati vetëm një rënie të lehtë, duke bërë që të thellohej edhe më tutje bilanci negativ tregtar i Kosovës<sup>23</sup> (shih tabelën 1.2). Një vit pas pavarësisë, në vitin 2009, eksportet e Kosovës në Serbi vazhduan të përgjysmohen edhe më tutje në krahasim me vitin paraprak. Gjatë vitit 2009 Kosova kishte eksportuar në Serbi mallra në vlerë prej vetëm 3,504 milion Euro.<sup>24</sup> Pavarësisht embargos së vendosur nga shteti i Serbisë, eksportuesit kosovar kishin arritur të gjenin mënyra të tjera për të eksportuar produktet e tyre në Serbi përmes ri-eksportimit të tyre përmes Malit të Zi dhe Maqedonisë, me dokumentet doganore të atyre vendeve.<sup>25</sup>

18 Po aty, fq.44.

19 Kodi Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 11 nëntor 2008, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2600>

20 International Alert, "Rregullimi i tregtisë përgjatë kufijve të kontestuar: Rastet e Kinës / Tajvanit, Serbisë / Kosovës dhe Qipros", Autor dhe editor: Natalia Mirimanova, prill 2015, fq.45.

21 Intervistë e KDI-së me një përfaqësues të Kosovës në dialogun me Serbinë, 5 maj 2020.

22 KIPRED, Analizë e Politikave: "Kosova në Kontekst Rajonal Marrëdhëniet Ekonomike dhe Tregtare", korrik 2013, fq.53 në, [http://www.kipred.org/repository/docs/Kosova\\_n%C3%AB\\_Kontekst\\_Rajonal\\_Marr%C3%ABdh%C3%ABniet\\_Ekonomike\\_dhe\\_Tregtare\\_851607.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Kosova_n%C3%AB_Kontekst_Rajonal_Marr%C3%ABdh%C3%ABniet_Ekonomike_dhe_Tregtare_851607.pdf)

23 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Tregtisë së Jashtme 2002-2010, në, <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/tregtia-e-jashtme>

24 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Tregtisë së Jashtme 2002-2010, në, <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/tregtia-e-jashtme>

25 "Monitoring of Implementation of the Agreement Concluded between Kosovo and Serbia in the Field of Free Movement of People and Goods", Authors: Predrag Bjelic, Bisera Seceragic, Albert Krasniqi, Vladimir Petronijevic, Miroslava Jelacic, Doruntina Vinca, fq.12 në, [https://www.centarzaregionalizam.org.rs/prilozi/monitoring/Monitoring\\_ENG.pdf](https://www.centarzaregionalizam.org.rs/prilozi/monitoring/Monitoring_ENG.pdf)

TABELA 1.2: Shkëmbimet tregtare Kosovë-Serbi gjatë periudhës 2008-2013

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013
<b>Export</b>	9,893,000.00 €	3,504,000.00 €	3,941,000.00 €	7,198,000.00 €	14,968,000.00 €	14,463,000.00 €
<b>Import</b>	208,951,000.00 €	210,901,000.00 €	260,471,000.00 €	254,917,000.00 €	278,388,000.00 €	285,356,000.00 €

Shpallja e pavarësisë së Kosovës

Marrëveshjet për lëvizjen e lirë, vulat doganore dhe IBM

Marrëveshja për mbledhjen e të hyrave doganore

Përderisa sasia e eksporteve të Kosovës drejt Serbisë po binte, importet nga Serbia në Kosovë kishin shënuar rritje gjatë vitit 2009 me importe vjetore në vlerë prej 210.901 milionë Euro.<sup>26</sup> Në vitin 2010, eksportet e Kosovës në Serbi ishin rritur lehtë, ndërsa importet nga Serbia vazhduan të rriteshin në vlera të larta me shifrën vjetor që kishte arritur 260.471 milionë Euro gjatë këtij viti (shih tabelën 1.2).

Përveç kompanive eksportuese edhe kompanitë importuese kosovare përballeshin me pengesa gjatë kalimit transit nëpër Serbi. Autoritetet serbe kërkonin nga kompanitë kosovare të siguronin një dokument ose certifikatë importi/transiti që lëshohej nga Ministria e Bujqësisë e Serbisë. Në situata të tilla, kompanitë importuese kosovare kishin dy mundësi: të aplikonin për licencë të importit/licencë të kalimit transit, që lëshohej nga Drejtoria e Veterinarisë e Serbisë ose detyroheshin të ktheheshin prapa dhe të shfrytëzonin kufijtë e tjerë alternativë. Aplikimi për licencë tek autoritetet serbe merrte kohë dhe licenca ishte e vlefshme vetëm tre muaj, por edhe shfrytëzimi i kufijve tjerë kishte kosto kohore dhe financiare.<sup>27</sup> Në të dy rastet kompanitë importuese kosovare po pësonin humbje si pasojë e pengesave tregtare nga ana e Serbisë. Pasi Serbia nuk i njihte as targarat e regjistrimit të automjeteve të regjistruara në Kosovë, të gjitha kompanitë kosovare që eksportonin

dhe importonin mallra nga Serbia dhe në vendet e treta, gjatë kalimit nëpër Serbi i duhej të përdornin kamionët e regjistruar në Serbi ose vendet anëtare të BE-së.<sup>28</sup>

Kosova nuk ndërmori ndonjë hap për të iu përgjigjur bllokadës tregtare të Serbisë deri në vitin 2011 kur vendosi masat e reciprocitetit, disa muaj pas fillimit të dialogut teknik në Bruksel.

26 Po aty.

27 Intervistë e KDI-së me z.Zef Dedaj, Udhëheqës i Divizionit për Politika Tregtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, 21 prill 2020.

28 Po aty.

# 2

**Marrëveshjet e dialogut të  
Brukselit dhe kundërpërgjigjet  
e Kosovës ndaj masave  
tregtare të Serbisë**

---

Me 8 mars të vitit 2011, në Bruksel kishte filluar dialogu teknik mes Kosovës dhe Serbisë i lehtësuar nga z. Robert Cooper, i dërguar i Bashkimit Evropian (BE). Ky proces kishte filluar pas rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), e cila mirëpriste rolin e BE-së në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë për çështje teknike dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve.<sup>29</sup> Në kohën kur filloi procesi i dialogut tanimë ishin bërë tri vite prej kur Serbia kishte vendosur bllokadë tregtare ndaj eksporteve të Kosovës dhe kalimin transit të mallrave nëpër Serbi. Prandaj jo rastësisht temë e dialogut ishin edhe rregullimi i qarkullimit reciprok të njerëzve dhe mallrave mes Kosovës dhe Serbisë si dhe dokumentacioni mbi bazën e të cilit do të realizohej qarkullimi.

Si rrjedhojë, gjatë vitit 2011 në kuadër të procesit të dialogut, u arritën gjashtë konkluzë/marrëveshje teknike, ndër të cilat tri marrëveshje që ndërlidheshin me marrëdhëniet tregtare mes Kosovës dhe Serbisë, përkatësisht marrëveshja për lirinë e lëvizjes, për vullat doganore dhe menaxhimin e integruar të kufirit (IBM).<sup>30</sup>

Marrëveshja	Data
Lëvizjen e Lirë	<b>2 korrik 2011</b>
Vulat Doganore	<b>2 shtator 2011</b>
Menaxhimin e Integruar të Kufirit (IBM)	<b>2 dhjetor 2011</b>

Mirëpo, marrëveshjet e dialogut nuk kishin për qëllim rregullimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi në nivel ndërshtetëror. Përmbajtja e tyre përcaktonte modalitetet e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë pa njohje të shtetit të Kosovës nga kjo e fundit. Për më tepër, dykuptimësia e terminologjive të përdorura në tekste të marrëveshjeve e linte interpretimin e tyre në diskrecionin e palëve.<sup>31</sup>

Pas rreth katër muaj negociata në Bruksel, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshjen e parë në kuadër të dialogut teknik, atë për lirinë e lëvizjes mes dy shteteve.<sup>32</sup> Marrëveshja përcaktonte modalitetet e qarkullimit reciprok, me anë të një sistemi me anë të së cilit anashkalohej njohja e Kosovës si shtet nga ana e Serbisë. Në këtë mënyrë, qytetarët e Kosovës mund të udhëtonin në Serbi duke përdorur letërnjoftimet e tyre, mirëpo në hyrje në shtetin serb ata do të merrnin një dokument të udhëtimit që lejonte qëndrimin deri në 90 ditë. Ky dokument më pas duhet të dorëzohej për të dalë nga Serbia.<sup>33</sup>

Pavarësisht arritjes së marrëveshjes për lirinë e lëvizjes që lehtësoi deri diku qarkullimin e njerëzve mes Kosovës dhe Serbisë, kjo e fundit vazhdonte të mos lejonte eksportin e mallrave të Kosovës në Serbi me vullën doganore të Kosovës. Kjo çështje ishte temë e bisedimeve në Bruksel në kuadër të dialogut teknik, mirëpo Serbia kishte refuzuar të pranonte vullën doganore të Kosovës edhe pas disa raundeve të negociatave. Për këtë arsye, Kosova vendosi për aplikimin e masave të reciprocitetit ndaj Serbisë në vitin 2011.

29 Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për dialogun Kosovë-Serbi, e miratuar me 9 shtator 2010 në, [https://www.un.org/en/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=A/RES/64/298](https://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/64/298)

30 Shih të gjitha marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi në platformën e KDI-së Vota Ime, moduli: Dialogu Kosovë-Serbi në, <http://www.votaimë.org/Public/Dialog>

31 Analizë e shkurtër e KDI-së, "Dialogu Kosovë – Serbi: Sfidat dhe rruga përpara", mars 2018, fq.14 në, <http://www.votaimë.org/Public/Article?Dialog=true&Dialog=false&SelectedTab=Publications&SelectedMonthID=&SelectedYear=ëëpublications>

32 Shih tekstin e marrëveshjes për Lirinë e Lëvizjes në, [http://www.votaimë.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes\\_2korrik2011\\_XNF3UtPC2M.pdf](http://www.votaimë.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_2korrik2011_XNF3UtPC2M.pdf)

33 BIRN, "Big Deal: Të humbur në stagnim", Mbikëqyrja civile e zbatimit të marrëveshjes mes Kosovës e Serbisë, prill 2015, fq.23 në, <https://prishtinainsight.com/wp-content/uploads/2016/02/SHQIP-Publikim-BIGDEALWEB.pdf>

## 2.1 Vendosja e masave të reciprocitetit ndaj Serbisë për herë të parë në vitin 2011

Refuzimi për tre vite rresht i Serbisë që të pranonte vulën doganore me mbishkrimin “Dogana e Kosovës” shtyu Qeverinë e Kosovës, përkatësisht Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë që me 20 korrik 2011, të nënshkruante vendimin me anë të të cilit nuk do të njiheshin vulat doganore dhe të administratës tatimore të Serbisë dhe ndalohej importi i të gjitha mallrave të përcjella me dokumente që përmbanin këto vula.<sup>34</sup> E njëjta masë vlente edhe për Bosnje e Hercegovinën, ndërsa përveç kësaj, ndaj këtij shteti u vendos edhe tarifë doganore prej 10%.<sup>35</sup>

Pas vendosjes së reciprocitetit Serbia gjeti mënyra tjera për të eksportuar mallra në Kosovë, duke i kontrabanduar ato përmes pikave të kalimit kufitar të djegura në veri, të cilat nuk kontrolloheshin nga autoritetet kosovare. Prandaj, për të garantuar zbatimin e këtij vendimi në të gjitha pikë kalimet kufitare me Serbinë dhe për të vendosur autoritetet e Republikës së Kosovës në pikat e kalimit kufitar 1 dhe 31 në Jarinjë dhe Bërnjak, Qeveria e Kosovës me 25 korrik 2011 kishte urdhëruar edhe aksionin policor në këto pika.<sup>36</sup> Gjatë këtij aksioni policor ishte vrarë edhe zyrtari policor i Kosovës Enver Zymberi nga pjestarë të komunitetit serb në Veri.<sup>37</sup> Shteti i Kosovës nuk kishte arritur që të shrinte sovranitetin në pikë kalimet në Veri dhe pas këtij aksioni serbët lokal në Veri vendosën barrikada në rrugë. Ndërsa, në pikë kalimet 1 dhe 31 u vendosë KFOR-i, misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë.<sup>38</sup>

Masat e reciprocitetit të vendosura nga ana e Kosovës zgjatën 58 ditë, deri në arritjen e marrëveshjes për vulat doganore mes Kosovës dhe Serbisë me 2 shtator 2011 në Bruksel.<sup>39</sup> Këto masa e detyruan Serbinë që të nënshkruante marrëveshjen për vulën doganore me anë të së cilës ishte pajtuar që të pranonte vulën doganore “Dogana e Kosovës”. Mirëpo marrëveshja ishte arritur si rezultat i kompromisit të Kosovës, e cila kishte pranuar kushtëzimin e Serbisë që emërtimi “Republika e Kosovës” të mos vendosej në deklaratat doganore.<sup>40</sup>

Ndikimi i masave të reciprocitetit u reflektua edhe në vëllimin e importeve nga Serbia, të cilat shënuan rënie të madhe, sidomos gjatë muajit gusht ku vlera e mallrave ishte vetëm 3,837 milionë Euro, në krahasim me muajt paraprak ku shkalla e importit ishte shumëfish më e lartë (shih tabelën 1.3).

34 Vendimi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës për parimin e reciprocitetit në marrëdhëniet tregtare i 20 korrikut 2011, në <https://meptinis.rks-gov.net/desk/jinc/media/4A154821-BACC-4163-BDBC-3E531B5BD7F3.pdf>

35 Po aty.

36 Intervistë e KDI-së me një përfaqësues të Kosovës në dialogun me Serbinë, 5 maj 2020.

37 Lajmet e Zyrës së Kryeministrit: “Kryeministri Thaçi: Vendimi i mbrëmshëm i Qeverisë – demonstroi i drejtpërdrejt i përcaktimit tonë për rend dhe ligj, i përcaktimit tonë për luftimin e krimit dhe korrupsionit në çdo cep të Kosovës”, 26 korrik 2011 në, <https://kryeministri-ks.net/kryeministri-thaci-vendimi-i-mbremshem-i-qeverise-demonstroi-i-drejtperdrejt-i-percaktimit-tone-per-rend-dhe-ligj-i-percaktimit-tone-per-luftimin-e-krimit-dhe-korrupsionit-ne-cdo-cep-te-kosoves/>

38 BIRN, “Big Deal: Monotoni e Qytetëruar”, Mbikëqyrja Qytetare e Implementimit të Marrëveshjes Kosovë – Serbi, fq.17 në, <https://prishtinainsight.com/wp-content/uploads/2016/02/BIG-DEAL-1-FINAL-ALB-.pdf>

39 Shih tekstin e marrëveshjes për Vula Doganore në, [http://www.votaima.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes\\_2shtator2011\\_HRqzgXABx4.pdf](http://www.votaima.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_2shtator2011_HRqzgXABx4.pdf)

40 International Alert, “Rregullimi i tregtisë përgjatë kufijve të kontestuar: Rastet e Kinës / Tajvanit, Serbisë / Kosovës dhe Qipros”, Autor dhe editor: Natalia Mirimanova, prill 2015, fq.38.

**TABELA 1.3:** Shkëmbimet tregtare Kosovë-Serbi para dhe pas vendosjes së masave të reciprocitetit në vitin 2011

2011	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
<b>Export</b>	464,000.00 €	586,000.00 €	1,066,000.00 €	507,000.00 €
<b>Import</b>	28,909,000.00 €	18,717,000.00 €	3,837,000.00 €	13,341,000.00 €

BURIMI: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Qeveria e Kosovës tërhoqi masat e reciprocitetit më 16 shtator 2011. Sapo u hoqën masat e reciprocitetit nga ana e Kosovës, niveli i importeve nga Serbia filloi të rritej sërish dhe gjatë muajit shtator vlera e mallrave të importuar ishte 13,341 milionë Euro.

Edhe pse masat e reciprocitetit detyruan Serbinë që të pranonte vulën doganore të Kosovës, Serbia nuk po zbatonte këtë marrëveshje në terren. Fillimisht marrëveshja u zbatua vetëm pjesërisht në katër pikë kalime kufitare, ndërsa jo edhe në dy pikë kalimet e tjera kufitare në kufirin verior mes Kosovës dhe Serbisë (pikat 1 dhe 31). Kjo për shkak të prezencës së barrikadave rrugore në veri të cilat kishin bllokuar qarkullimin e mallrave që nga korriku i vitit 2011.<sup>41</sup> Në fund të vitit 2014, Qeveria e Kosovës kishte raportuar se gjendja e zbatimit të kësaj marrëveshje ishte e mirë, megjithatë herë pas here, kishte shkelje të marrëveshjes nga ana e Serbisë pasi autoritetet e saj kishin përdorur vula ilegale dhe provokative të ish-strukturave paralele në fushën e doganave dhe akronime të tjera provokuese në dokumente.<sup>42</sup> Po ashtu, Serbia nuk kishte hequr akoma doganat paralele nga strukturat e saj. Skema e strukturës

organizative të Administratës Doganore të Serbisë ende përfshinte zyrën doganore të Prishtinës.<sup>43</sup> Qeveria kishte raportuar për përdorimin e vulave paralele në të gjitha raportet e gjendjes së zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit përgjatë 4 viteve, duke përfshirë edhe raportin e fundit në qershor të vitit 2018.<sup>44</sup> Se Serbia po vazhdonte përdorimin e vulave paralele doganore e kishte konfirmuar edhe ish drejtori i Doganës së Kosovës Bahri Berisha, gjatë takimit me anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe përfaqësuesit e KDI-së të mbajtur me 4 dhjetor 2018.<sup>45</sup>

## 2.2 Modalitetet e funksionimit në pikë kalime kufitare me Serbinë. Arritja e Marrëveshjes së IBM-it

Pas arritjes së marrëveshjes për lirinë e lëvizjes në korrik 2011 dhe marrëveshjes për vulat doganore në shtator 2011 edhe një aspekt tjetër ndërkufitar mes Kosovës dhe Serbisë kishte mbetur ende pa u zgjidhur, ai i rregullimit të funksionimit të pikë kalimeve kufitare. Kështu, në dhjetor të vitit 2011

41 Gjendja në zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit, Raport i dorëzuar në Bashkimin Evropian nga Qeveria e Republikës së Kosovës, 16 janar 2014, fq.25 në [http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/GjendjaneZbatimineMarreveshjevetBrukselit\\_16janar2014\\_FqxFynpeS.pdf](http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/GjendjaneZbatimineMarreveshjevetBrukselit_16janar2014_FqxFynpeS.pdf)

42 Gjendja në zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit, Raport i dorëzuar tek Bashkimi Evropian nga Qeveria e Republikës së Kosovës, janar-shtator 2014, fq.21, në [http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/GjendjaneZbatimineMarreveshjevetBrukselit\\_Janar-Shtator2014\\_Ba3THspGU6.pdf](http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/GjendjaneZbatimineMarreveshjevetBrukselit_Janar-Shtator2014_Ba3THspGU6.pdf)

43 Shih ueb faqen zyrtare të Doganave të Serbisë në strukturën e të cilës është edhe zyra doganore Prishtina, në <https://www.carina.rs/en/Contact/Pages/Contact.aspx>

44 Raporti mbi Arritjet dhe Sfidat në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit, 18 qershor 2018, fq.18 në [http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbiarritjetdhesfidatnezbatimineMarreveshjevetBrukselit\\_18qershor2018\\_GAc6YnWvKU\(1\)\\_hx-wNkAUHPK.pdf](http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbiarritjetdhesfidatnezbatimineMarreveshjevetBrukselit_18qershor2018_GAc6YnWvKU(1)_hx-wNkAUHPK.pdf)

45 "Deputetët informohen nga Dogana e Kosovës për zbatimin e marrëveshjeve të dialogut dhe masën mbrojtëse prej 100%", 4 dhjetor 2018 në <http://www.votaim.org/Public/DialogActivity/Detail/261>



Masat e reciprocitetit të vendosura nga ana e Kosovës në korrik të vitit **2011** zgjatën **58 ditë**, deri në arritjen e marrëveshjes për vulat doganore mes Kosovës dhe Serbisë me **2 shtator 2011** në Bruksel.

mes Kosovës dhe Serbisë u arrit e ashtuquajtura marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufirit – IBM.

Ishte situata e brishtë në pikë kalimet me Serbinë në Veri, që rezultoi me diskutimet rreth kësaj çështje në kuadër të procesit të dialogut Kosovë-Serbi dhe marrëveshjen e IBM-it.<sup>46</sup> Deri në arritjen e kësaj marrëveshje tregtia e mallrave mes Kosovës dhe Serbisë është realizuar kryesisht përmes pikëve kufitare në Merdare.<sup>47</sup>

Ashtu si marrëveshjet paraprake të Brukselit edhe kjo marrëveshje përcaktonte marrëdhënie ndërkufitare mes Kosovës dhe Serbisë, pa njohjen e Kosovës si shtet. Shkurtesa IBM e përdorur në këtë marrëveshje kishte dy kuptime, kufi shtetërorë dhe kufi administrativ dhe përdorimi i secilit term mbetej në diskrecionin e palëve.<sup>48</sup> Dykuptimësia ishte kompromis mes palëve dhe ishte vendosur për shkak të refuzimit të Serbisë që me anë të kësaj marrëveshje të njëjtte shtetësinë e Kosovës me kufijtë e saj.

Marrëveshja parashihte që mes Kosovës dhe

Serbisë të vendoseshin gjashtë pikë kalime kufitare fillimisht të përkohshme e pastaj të përhershme. Me asistencën e BE-së, tri nga pikë kalimet do të ndërtoheshin nga Kosova dhe tri tjera nga Serbia. Kjo marrëveshje u negociua disa herë edhe gjatë viteve në vijim, ku u vendos për ndërtimin e pikëve kalimeve tjera kufitare shtesë në Kapi dhe në Izvor.<sup>49</sup>

Marrëveshja e IBM-it ishte njëra ndër marrëveshjet e dialogut që ishte kundërshtuar më së shumti nga ana e Serbisë.<sup>50</sup> Në kuadër të procesit të zbatimit, vendosja e zyrtarëve doganor në veri ishte përcjellë me akte të dhunës nga ana e pjestarëve të komunitetit serb në këtë zonë. Me 19 shtator të vitit 2013, atje ishte vrarë një pjesëtarë i EULEX-it, pas sulmit ndaj dy veturave të EULEX-it që i bartnin gjashtë pjesëtarë për të bërë ndërrimin e rregullt në Portën 1, në afërsi të Komunës së Zveçanit.<sup>51</sup> Që nga ajo periudhë nuk ka pasur incidente të tilla, mirëpo ende kompanitë kosovare përballen me sfida në pikat e kalimit kufitar me Serbinë. Dërgesat e mallrave nuk mund të inspektohen për shkak të mungesës së inspektorëve veterinarë dhe fito sanitar në këto pika që nënkupton, që eksportuesit kosovar duhet të kalojnë kilometra shtesë për inspektim. Kjo situatë rezulton

46 Shih përmbajtjen e marrëveshjes së IBM-it të arritur me 2 dhjetor 2011, në platformën e KDI-së Vota Ime në, [http://www.votaima.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes\\_2dhjetor2011\\_TYPMU5YGcB.pdf](http://www.votaima.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_2dhjetor2011_TYPMU5YGcB.pdf)

47 International Alert, "Rregullimi i tregtisë përgjatë kufijve të kontestuar: Rastet e Kinës / Tajvanit, Serbisë / Kosovës dhe Qipros", Autor dhe editor: Natalia Mirimanova, prill 2015, fq.28.

48 Shih përmbajtjen e marrëveshjes së IBM-it e arritur në Bruksel me 2 dhjetor 2011, në [http://www.votaima.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes\\_2dhjetor2011\\_TYPMU5YGcB.pdf](http://www.votaima.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_2dhjetor2011_TYPMU5YGcB.pdf)

49 Raport mbi gjendjen në zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit, 1 janar – 15 qershor 2016, fq.22, në [http://votaima.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbiGjendjenneZbatimineMarreveshjeveteBrukselit\\_1janar-15qershor2016\\_4hMDtTBcLH.pdf](http://votaima.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbiGjendjenneZbatimineMarreveshjeveteBrukselit_1janar-15qershor2016_4hMDtTBcLH.pdf)

50 Po aty.

51 Radio Evropa e Lirë, "Vritet një pjesëtar i EULEX-it", 19 shtator 2013 në, <https://www.evropaelire.org/a/25110852.html>



me vonesa dhe rritje të kostos së transportit. Për më tepër, inspektorët veterinarë dhe fito sanitar serbë punojnë me orar të shkurtuar dhe pas orës 14:00 kamionët kosovarë detyrohen të presin deri ditën tjetër. Për pasojë, kompanitë kosovare përballen me kosto shtesë kohore dhe financiare në kufi me Serbinë.<sup>52</sup> Aktualisht marrëveshja e IBM-it është ende në proces të zbatimit.<sup>53</sup> Serbia nuk ka shënuar progres në përmbushjen e obligimeve për zbatimin e kësaj marrëveshje, ndërsa ka penguar vazhdimisht Kosovën në këtë aspekt.<sup>54</sup>

### 2.3 Mbledhja e të hyrave doganore ndryshe nga pikë kalimet kufitare në veri. Krijimi i Fondit Zhvillimor për veriun

Pas përcaktimit të modaliteteve të funksionimit të pikë kalimeve kufitare Kosovë-Serbi përmes konceptit të IBM-it, sfidë tjetër në këto pika mbetej mbledhja e të hyrave doganore. Kjo çështje u bë pjesë e diskutimeve në Bruksel, për arsye se që nga shpallja e pavarësisë Serbia kishte kundërshtuar vendosjen e autoriteteve shtetërore të Kosovës në pikë kalimet kufitare në veri. Prandaj, modalitetet e funksionimit të kësaj pjese u bënë edhe temë e diskutimit në procesin e dialogut, pas ndryshimit të formatit të këtij procesi nga teknik në politik në tetor të vitit 2012. Disa muaj pas, më 17 janar 2013, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshjen për mbledhjen e të hyrave doganore, e cila parashihte modalitetet e grumbullimit të detyrimeve doganore, detyrimeve të akcizës dhe TVSH-së në pikë kalimet kufitare në veri.<sup>55</sup> Mirëpo, marrëveshja përcaktonte

që grumbullimi i mjeteve monetare në këto pika do të shkonte në të ashtuquajturin Fondi Zhvillimor për veriun dhe mbledhja e tyre do të fillonte pas themelimit të fondit.

Edhe pse marrëveshja për mbledhjen e të hyrave doganore ishte marrëveshje e re e dialogut Kosovë-Serbi, përmbajtja e saj ishte e njohur vite më parë. Ajo ishte prezantuar qysh në vitin 2008 disa muaj pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.<sup>56</sup> Më 24 nëntor të vitit 2008 ish sekretari i OKB-së i asaj kohe Ban Ki Moon kishte prezantuar një plan gjashtë pikësh për Kosovën lidhur me modalitetet e vendosjes së misionit të BE-së EULEX në Kosovë.<sup>57</sup> I mbështetur nga Serbia, ky plan parashihte ndër të tjera sovranitet ndërkombëtar në pikë kalimet kufitare me Serbinë në veri, në pikat 1 dhe 31. Ky plan më tej përcaktonte që mbledhja e të hyrave doganore nga këto pika do të shkonte në një fond për zhvillimin e komunave veriore. Në këtë drejtim, Serbia kishte arritur që të realizonte kërkesat e saj të vitit 2008 rreth pikë kalimeve në veri, në kuadër të dialogut të Brukselit në vitin 2013.

Fondi për veriun për nga natyra është i paprecedent, dhe nuk gjen krahasim me ndonjë vend tjetër, meqë këto komuna nuk kanë veçori të caktuara territoriale ose rajonale brenda shtetit të Kosovës. Partitë politike në Kosovë e kanë kundërshtuar krijimin e një fondi të tillë të cilin e kanë konsideruar si hapje e rrugës për zhvillimin e autonomisë së pjesës veriore të Kosovës. Fondi po ashtu është kritikuar nga analistë për shkak të krijimit *de facto* të një rajoni të veçantë në Kosovë.<sup>58</sup>

52 Intervistë e KDI-së me z.Zef Dedaj, Udhëheqës i Divizionit për Politika Tregtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, 21 prill 2020.

53 "Raporti mbi Arritjet dhe Sfidat në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit" i Qeverisë së Kosovës, 18 Qershor 2018, fq.21-24 në [http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbiarritjetdhesfidatnezbatimimeMarreveshjeveteBrukselit\\_18qershor2018\\_GAc6YnWvKU\(1\)\\_hxwNKAUHPK.pdf](http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbiarritjetdhesfidatnezbatimimeMarreveshjeveteBrukselit_18qershor2018_GAc6YnWvKU(1)_hxwNKAUHPK.pdf)

54 Intervistë e KDI-së me një përfaqësues të Kosovës në dialogun me Serbinë, 5 maj 2020.

55 Shih përmbajtjen e marrëveshjes për mbledhjen e të hyrave doganore, e arritur mes Kosovës dhe Serbisë në Bruksel më 17 janar 2013 në [http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes\\_17janar2013\\_bfvh4eHbPr.pdf](http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_17janar2013_bfvh4eHbPr.pdf)

56 International Alert, "Rregullimi i tregtisë përgjatë kufijve të kontestuar: Rastet e Kinës / Tajvanit, Serbisë / Kosovës dhe Qipros", Autor dhe editor: Natalia Mirimanova, prill 2015, fq.27.

57 Shih planin gjashtë pikësh të ish Sekretarit të OKB-së Ban Ki Moon të datës 24 nëntor 2008 në <https://undocs.org/S/2008/692>

58 Hulumtim Parlamentar "Fondi për Zhvillimin e veriut" fq.6, përgatitur për Komisionin parlamentar për Buxhet dhe Financa nga Oda Amerikane, janar 2018, në kuadër të projektit të KDI-së: Forcimi i mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi, i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës.



## Kosova riktheu sërish masat e reciprocitetit ndaj **Serbisë** në vitin **2015**, si kundërpërgjigje ndaj bllokadës së eksporteve të **Kosovës** nga muaji **shtator 2015**.

Përveç marrëveshjes për mbledhjen e të hyrave doganore me anë të së cilës u krijua Fondi i veçantë për veriun, diferencimi i kësaj pjesë u bë edhe me anë të marrëveshjeve tjera të dialogut si ajo për policinë, gjyqësorin, energjinë dhe telekomin.<sup>59</sup> Me raste ka pasur edhe deklarata nga kreu i shtetit, i cili ka lënë të nënkuptohet se një pjesë e Veriut mund të ishte pjesë e ndonjë marrëveshje finale me Serbinë në kuadër të dialogut.<sup>60</sup> Mbi këtë parim, u prezantua ideja për korrigjimin e kufijve mes Kosovës dhe Serbisë në vitin 2018, e cila në thelb proklamonte shkëmbimin e territoreve si zgjidhje për përfundimin e konfliktit politik mes dy shteteve.

### 2.4 Vazhdimi i kontestimit të shtetësisë së Kosovës dhe rikthimi i masave të reciprocitetit ndaj Serbisë në vitin 2015

Pas arritjes së marrëveshjeve të lartpërmendura të dialogut, marrëdhëniet tregtare Kosovë-Serbi deri diku u rregulluan, megjithatë ato vazhduan të zhvillohen në një mjedis me barriera tregtare si masa politike në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë.

Po ashtu, marrëveshjet e Brukselit që ishin arritur në letër, nuk po zbatoheshin në terren.

Kosova riktheu sërish masat e reciprocitetit ndaj Serbisë në vitin 2015, si kundërpërgjigje ndaj bllokadës së eksporteve të Kosovës nga muaji shtator 2015. Autoritetet serbe kishin vendosur pengesa të vazhdueshme tregtare ndaj kompanive kosovare që transportonin naftë dhe gaz nga Serbia duke mos e njohur certifikatën ADR të shtetit të Kosovës.<sup>61</sup> Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës kishte marrë vendim për aplikimin e masave të reciprocitetit për mosnjohjen e certifikatave ADR të Serbisë dhe kishte ndaluar importin e mallrave të rrezikshme nga Serbia. Këto masa vazhduan deri në hyrjen në fuqi të marrëveshjes së Brukselit për njohjen reciproke të certifikatave ADR<sup>62</sup> në prill të vitit 2016.<sup>63</sup> Kjo ishte hera e dytë që masat e reciprocitetit ndaj Serbisë ishin treguar të suksesshme për të detyruar Serbinë që të pranonte dokumentet e Republikës së Kosovës në marrëdhëniet tregtare reciproke. Megjithatë, për dallim nga masat e reciprocitetit për vulat doganore, ku Serbia vazhdoi të përdorte vula paralele edhe pas arritjes së marrëveshjes respektive, në rastin e

59 Shih përmbajtjen e këtyre marrëveshjeve në platformën e KDI-së Vota Ime: Moduli Dialogu Kosovë-Serbi në, <http://www.votaimo.org/Public/Dialog>

60 Koha Net "Thaçi do t'ia kthejë Serbisë "dhuratën" e Rankoviçit", 22 shtator 2018 në <https://www.koha.net/arberi/118613/thaci-do-tia-ktheje-serbise-dhuraten-e-rankoviqit/>

61 Intervistë e KDI-së me z.Zef Dedaj, Udhëheqës i Divizionit për Politika Tregtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, 21 prill 2020.

62 Shih përmbajtjen e marrëveshjes së Brukselit për njohjen reciproke të certifikatave ADR të arritur me 19 prill 2016, në [http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes\\_19prill2016\\_PUD83nawaG.pdf](http://www.votaimo.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_19prill2016_PUD83nawaG.pdf)

63 Zyra e Kryeministrit të Kosovës, "Reciprocitet në njohje të certifikatave shtetërore ADR", 20 prill 2016 në, <https://kryeministri-ks.net/reciprocitet-ne-njohje-te-certifikatave-shteterore-adr/>

certifikatave ADR, marrëveshja është zbatuar nga ana e Serbisë dhe nuk janë shënuar ankesa nga ana e kompanive kosovare për mosnjohjen e këtyre certifikatave nga ana e Serbisë.<sup>64</sup>

Njohje reciproke në certifikatat tregtare mes Kosovës dhe Serbisë para atyre ADR ishte arritur edhe për certifikatat e produkteve medicinale, me 27 qershor 2015. Kjo marrëveshje mundësonte normalizimin e tregtisë në fushën e produkteve medicinale mes dy shteteve si dhe regjistrimin e barnave të importuara para shitjes në treg në përputhje me legjislacionin në fuqi.<sup>65</sup> Mirëpo marrëveshja hasi probleme në zbatim sepse Serbia nuk ofroi licenca për tregtarët për eksportin dhe regjistrimin e produkteve farmaceutike në Kosovë.<sup>66</sup> Prodhuesit farmaceutikë nga Kosova ende hasin në pengesa gjatë eksportimit të produkteve farmaceutike në Serbi për shkak të kërkesave nga kjo e fundit për t'u regjistruar si eksportues nga Kosova tek autoritetet serbe. Përveç kësaj, regjistrimi nuk pranohet nga autoritetet serbe, nëse dokumentet e lëshuara nga autoritetet kosovare nuk i referohen Kosovës me status neutral.<sup>67</sup>

Serbia vazhdon të aplikojë ndaj Kosovës edhe një numër të madh të barrierave jo tarifore duke përfshirë refuzimin e produkteve me origjinën kosovare. Barrierat e aplikuara ndaj Kosovës janë të natyrave të ndryshme, duke përfshirë të ashtuquajturat Barrierat Teknike të Tregtisë dhe Standardet Sanitare dhe Fito sanitare. Në të njëjtën kohë, kalimi transit i produkteve të Kosovës nëpër Serbi ende ballafaqohet me pengesa administrative të vazhdueshme.<sup>68</sup> Shpeshherë produktet bujqësore me origjinë nga Kosova nuk lejohen të eksportohen

për shkak të etiketës që tregon se produkti është prodhuar në Kosovë. Autoritetet serbe nuk njohin raportin e kualitetit të produkteve bujqësore të eksportuesve kosovar dhe kërkojnë analiza shtesë për secilën dërgesë. Këto procese të gjata të inspektimit krijojnë kosto shtesë kohore dhe financiare për eksportuesit e Kosovës. Përveç analizave testuese, autoritetet serbe shpeshherë nuk njohin as certifikatat veterinarë dhe fito sanitare të lëshuara nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës (AUVK).<sup>69</sup>

Në nëntor të vitit 2018, Kosova vendosi tarifë 100% ndaj Serbisë. Qeveria e Kosovës listoi barrierat tregtare të aplikuara nga ana e Serbisë ndaj Kosovës megjithatë arsyeja kryesore për vendosjen e tarifës ishte politike.

64 Intervistë e KDI-së me z.Zef Dedaj, Udhëheqës i Divizionit për Politika Tregtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, 21 prill 2020.

65 Zyra e Kryeministrit të Kosovës, "Arrihet marrëveshja për njohjen reciproke të certifikatave të produkteve medicinale mes Kosovës dhe Serbisë", 27 qershor 2015 në, <https://kryeministri-ks.net/arrihet-marreveshja-per-njohjen-reciproke-te-certifikatave-te-produkteve-medicinale-mes-kosoves-dhe-serbise/>

66 BIRN, "Big Deal: Të përçarë-Mbikëqyrja civile e zbatimit të marrëveshjes mes Kosovës e Serbisë", fq.34 në, <https://prishtinainsight.com/wp-content/uploads/2016/02/SHQIP-publikim-BIGDEAL3-print-1.pdf>

67 Intervistë e KDI-së me z.Zef Dedaj, Udhëheqës i Divizionit për Politika Tregtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, 21 prill 2020.

68 Shih letrën e kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës Berat Rukiqi drejtuar Kryeministrit Kurti me datën 13 shkurt 2020 në, <https://telegrafi.com/rukiqi-leter-te-hapur-kurtit-zevendesimi-taksesh-te-shoqerohet-nje-varg-kerkesash-ndaj-serbise/>

69 Intervistë e KDI-së me z.Zef Dedaj, Udhëheqës i Divizionit për Politika Tregtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, 21 prill 2020.

# 3

**Faza finale e dialogut dhe  
masat tregtare si mjet për  
pengimin e shkëmbimit të  
territoreve**

---

Kosova vendosi të rikthente masat tregtare ndaj Serbisë pas zhvillimeve në fazën finale të dialogut me Serbinë e cila kishte filluar me 3 korrik 2017 në Bruksel, në mes Presidentit të Kosovës Hashim Thaçi dhe Presidentit të Serbisë Aleksandar Vuçiq.<sup>70</sup> Informacionet rreth asaj se çfarë ishte diskutuar në këtë takim dhe takimet tjera pasardhëse në mes Presidentëve nuk dihen, duke vazhduar kështu praktika e mos transparencës, problem ky që e ka shoqëruar këtë proces dialogu që nga fillimi. Rreth një vit pas, me 3 gusht 2018, Presidenti Thaçi shpali në opinion idenë e korigjimit të kufijve me anë të së cilës, sipas tij, Lugina së Preshevës do ti bashkohej territorit të Kosovës.<sup>71</sup> Përderisa Presidenti insistonte në konferenca të njëpasnjëshme për shtyp, se fjala ishte vetëm për korigjimin e një padrejtësie historike e cila kishte lënë Luginën e Preshevës jashtë Kosovës, ky projekt po shihej me skepticizëm brenda Kosovës, si nga spektri politik në vend ashtu edhe nga shoqëria civile dhe publiku i gjerë. Dyshimet ishin se pas kësaj ideje fshihej projekti për shkëmbimin e territoreve mes Kosovës dhe Serbisë që po planifikohej të realizohej në kuadër të fazës finale të dialogut.<sup>72</sup> Njohës të këtij procesi kishin alarmuar se kjo ide kishte gjetur përkrahje edhe tek disa përfaqësues ndërkombëtar në BE<sup>73</sup> dhe administratën amerikane<sup>74</sup>, megjithëse nuk kishte ndonjë deklaratë zyrtare në këtë drejtim. Përfaqësues amerikan kishin deklaruar se ata ishin të gatshëm të konsideronin çdo marrëveshje për të cilën Kosova dhe Serbia do të arrinin dakordim,

megjithatë, jo çfarëdo lloj marrëveshje.<sup>75</sup> Edhe emisari special amerikan për dialogun Richard Grenell kishte deklaruar se ideja e shkëmbimit të territoreve nuk është diskutuar asnjëherë në praninë e tij.<sup>76</sup>

### 3.1 Vendosja e tarifës 100% ndaj Serbisë si mjet politik

Mundësia e shkëmbimit të territoreve përmes një marrëveshje finale mes Kosovës dhe Serbisë, kishte ngjallur reagim edhe të kryeministrit të asaj kohe Ramush Haradinaj. Ndonëse, ai kishte hequr dorë nga roli i tij kushtetues në procesin e dialogut, duke e kaluar këtë proces në tërësi në udhëheqjen e Presidentit Thaçi. Megjithatë, Haradinaj nuk ishte dakord që të diskutohej apo të ndryshohej territori i Kosovës në kuadër të marrëveshjes finale Kosovë - Serbi. Siç kishte deklaruar ai disa herë, e vetmja zgjidhje e pranueshme do të ishte një marrëveshje që nuk prek kufijtë e Republikës së Kosovës të përcaktuar me 17 shkurt 2008.<sup>77</sup> Ideja e shkëmbimit të territoreve u bë objekt i përçarjeve mes tij dhe Presidentit Thaçi, i cili pavarësisht kundërshtimeve brenda vendit po vazhdonte avancimin e kësaj ideje përpara. Me gjithë përpjekjet për të penguar Presidentin, spektri politik i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës nuk arritën as të kalojnë një rezolutë të përbashkët rreth kësaj çështje. Projekt rezolutat e propozuara herë nga partitë në pushtet

70 Zyra e Presidentit të Kosovës, "Fillon një fazë e re në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", 3 korrik 2017 në, <https://president-ksgov.net/sq/lajme/fillon-nje-faze-e-re-ne-dialogun-per-normalizimin-e-marredhenieve-ndermjet-kosoves-dhe-serbise>

71 Zyra e Presidentit të Kosovës, "Fjala e presidentit Thaçi në konferencën për media rreth bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën", 3 gusht 2018 në, <https://president-ksgov.net/sq/lajme/fjala-e-presidentit-thaci-ne-konferencen-per-media-5536>

72 The Guardian, "A Kosovo-Serbia land swap is ethnic cleansing by another name. Don't do it", Agron Bajrami, 17 tetor 2018 në, <https://www.theguardian.com/commentisfree/2018/oct/17/kosovo-serbia-land-swap-ethnic-cleansing>

73 Koha Net, "Tagesspiegel: Gjermania kritika Mogherinit se po e mbështet idenë e shkëmbimit të territoreve Kosovë-Serbi", 20 prill 2019 në, <https://www.koha.net/arberi/158110/tagesspiegel-gjermania-kritika-mogherinit-se-po-e-mbeshtet-idene-e-shkembimit-te-territoreve-kosove-serbi/>

74 Portali Kallxo, "Daniel Serwer: Me shkëmbimin e kufijve, Kosova rreshqet prapa", 7 shtator 2018 në, <https://kallxo.com/gjate/interviste/daniel-serwer-me-shkembimin-e-kufijve-kosova-rreshqet-prapa/>

75 "Intervista e ambasadorit Kosnett për portalin KosSev", 28 dhjetor 2018 në, <https://xk.usembassy.gov/sq/intervista-e-ambasadorit-kosnett-per-portalin-kossev/>

76 Zëri i Amerikës "Grenell: Shkëmbimi i territoreve Kosovë - Serbi, nuk është një opsjon", 27 mars 2020 në, <https://www.zeriamerikes.com/a/us-kosovo/5349243.html>

77 "Kryeministri Haradinaj: Në tavolinat e bisedimeve me Serbinë nuk do të negociohet shkëmbimi i territoreve", 26 dhjetor 2018 në, <https://kryeministri-ks.net/kryeministri-haradinaj-ne-tavolinat-e-bisedimeve-me-serbine-nuk-do-te-negociohet-shkembimi-i-territoreve/>



Kosova vendosi të rikthente masat tregtare ndaj Serbisë pas zhvillimeve në fazën finale të dialogut me Serbinë e cila kishte filluar me **3 korrik 2017 në Bruksel**, në mes Presidentit të Kosovës Hashim Thaçi dhe Presidentit të Serbisë Aleksandar Vuçiq.

e herë nga ato në opozitë dështuan si rezultat i mospajtimeve politike dhe kalkulimeve partiake.<sup>78</sup> Edhe një Delegacion Shtetëror i krijuar nga Qeveria me qëllimin për të udhëhequr me procesin e dialogut, në fund u shpall kundër kushtetues nga Gjykata Kushtetuese. Megjithatë, në aktgjykimin e saj të datës 27 qershor 2019,<sup>79</sup> Gjykata rikonfirmoi dispozitat kushtetuese që e përcaktonin Qeverinë si udhëheqëse të politikës së jashtme duke përfshirë edhe dialogun, në konsultim me Presidentin.

Në përpjekje për të stopuar avancimin e idesë së shkëmbimit të territoreve, Qeveria Haradinaj në nëntor të vitit 2018 vendosi tarifë, fillimisht 10%<sup>80</sup> e më pas 100%<sup>81</sup>, ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Në shikim të parë, vendimi për tarifën dukej se ishte vendosur si ndëshkim tregtar ndaj Serbisë pas fushatës ndërkombëtare kundër njohjeve të shtetit të Kosovës dhe anëtarësimit të

saj në organizata ndërkombëtare që rezultuan me dështimin e anëtarësimit të Kosovës në organizatën INTERPOL.<sup>82</sup> Mirëpo, më vonë doli që arsyeja e vërtetë për vendosjen e kësaj tarife ishte pengimi i realizmit të idesë kontraverse për shkëmbimin e territoreve mes Kosovës dhe Serbisë.<sup>83</sup>

Menjëherë pas vendosjes së tarifës 100% kishte ardhur edhe reagimi i përfaqësuesve të lartë serb, të cilët kishin vendosur të tërhiqeshin nga procesi i dialogut deri në largimin e tarifës 100% nga ana e Kosovës.<sup>84</sup> Pezullimi i dialogut aktivizoi edhe përfaqësuesit evropian dhe amerikan, të cilët filluan kërkesat e tyre ndaj qeverisë së Kosovës për pezullimin e kësaj mase për një kohë të caktuar.<sup>85</sup> Përfaqësuesit evropian e sidomos ata amerikan kërkonin nga Qeveria e Kosovës që të pezullonte menjëherë tarifën ndaj Serbisë, për t'i hapur rrugën vazhdimit të dialogut Kosovë-Serbi. Vetëm pas

78 Shih raportin e KDI-së "Dialogu Kosovë-Serbi gjatë vitit 2018 në Kuvendin e Kosovës" në <http://www.votaimo.org/Public/Article?Dialog=true&Dialog=false&SelectedTab=Publications&SelectedMonthID=&SelectedYear=ëëpublications>

79 Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. K043/19, "Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, 27 qershor 2019 në, [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/06/ko\\_43\\_19\\_agj\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/06/ko_43_19_agj_shq.pdf)

80 Vendimi i Qeverisë për vendosjen e masës mbrojtëse 10% ndaj produkteve të Serbisë dhe BeH i datës 6 nëntor 2018 në, [https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/11/IMG\\_2387.jpg](https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/11/IMG_2387.jpg)

81 Vendimi i Qeverisë për vendosjen e masës mbrojtëse 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe BeH i datës 6 nëntor 2018 në, <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/11/Lista-e-mallrave-te-perjashtuara.pdf>

82 Arsyetimi i Qeverisë për vendosjen e masave mbrojtëse ndaj Serbisë dhe BeH në, <https://kryeministri-ks.net/kosova-i-ben-thirrje-komunitetit-nderkombetar-te-mbeshetese-perputhshmerine-me-marreshjet-nderkombetare/>

83 Koha Net, "Haradinaj: Taksa po e pengon formalizimin për ndarje", 25 shkurt 2019 në <https://www.koha.net/arberi/147110/haradinaj-taksa-po-e-pengon-formalizimin-per-ndarje/>

84 Reuters, "Serbia to resume Kosovo talks only after it scraps tariffs, Vucic tells Trump", 31 janar 2019 në, <https://www.reuters.com/article/us-serbia-usa-kosovo/serbia-to-resume-kosovo-talks-only-after-it-scraps-tariffs-vucic-tells-trump-idUSKCN1PP1X9>

85 Deklaratë e Ambasadës Amerikanë në Kosovë rreth tarifës, 25 janar 2019 në <https://xk.usembassy.gov/statement-from-u-s-embassy-pristina-2/>



Në përpjekje për të stopuar avancimin e idesë së shkëmbimit të territoreve, **Qeveria Haradinaj** në nëntor të vitit 2018 vendosi tarifë, fillimisht **10%** e më pas **100%**, ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës.

insistimit të Kosovës për të mbajtur tarifën, rreth një vit pas, përfaqësues të lartë amerikan filluan të kërkojnë edhe nga Serbia ndërprerjen e fushatës së saj lobuese kundër njohjeve të Kosovës.<sup>86</sup>

Kërkesat ndërkombëtare, ato të BE-së dhe SHBA-ve për tarifën u bënë përcaktues edhe të qëndrimeve të subjekteve politike në Kosovë dhe shkas i thellimit të përçarjeve të brendshme. Mundësia e rrezikimit të partneritetit ndërkombëtar me SHBA-të ndryshoi qëndrimet e përfaqësuesve politik në Kosovës të cilët më herët kishin mbështetur tarifën 100% ndaj Serbisë. Pas presionit ndërkombëtar partnerët e koalicionit PDK, NISMA dhe AKR kërkonin nga kryeministri Haradinaj që të pezullonte tarifën për t'i hapur rrugë dialogut ku opsionet për pezullim të përkohshëm të kësaj mase nuk munguan, si në rastin e propozimit të bërë nga ish kryetari i Kuvendit Kadri Veseli, për periudhë 120 ditë me mundësi të rikthimit të saj të mëvonshëm.<sup>87</sup> Në anën tjetër kryeministri Haradinaj vazhdonte të insistonte që taksa 100% të mbetej në fuqi deri në njohjen e Kosovës nga

Serbia, duke kërkuar garanci nga përfaqësuesit ndërkombëtar që në kuadër të procesit të dialogut të mos diskutohej për integritetin territorial të Kosovës.<sup>88</sup> Me 19 korrik 2019, Kryeministri Haradinaj dha dorëheqje, e cila rezultoi me shpërndarjen e Kuvendit dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja në vend, të cilat sollën një koalicion të ri qeverisës të dy ish subjekteve opozitare LDK dhe LVV, i udhëhequr nga Albin Kurti.

Përderisa tarifa ndikoi negativisht në marrëdhëniet mes spektrit politik në Kosovë dhe raportet e Kosovës me partnerët ndërkombëtar, në aspektin ekonomik impakti i saj për ekonominë e Kosovës mbetet i diskutueshëm.<sup>89</sup> Në këtë drejtim, vendosja e tarifës ndikoi pozitivisht në rritjen e prodhimtarisë në Kosovë. Sepse, derisa importet nga Serbia pësuan rënie të madhe nga 388,928 milionë euro në vitin 2018, në vetëm 5,784 milionë euro në vitin 2019 (shih tabelën 1.4), prodhuesit e Kosovës përfituan në masë të caktuar, pasi që disa nga mallrat u zëvendësuan me prodhim prodhime vendore.<sup>90</sup>

86 Koha Net "Palmer: Prishtina të heqë taksën, e Beogradi të ndalë fushatën për de legjitimimin e pavarësisë së Kosovës", 6 nëntor 2019 në, <https://www.koha.net/arberi/192633/palmer-prishtina-te-heqe-taksen-e-serbise-te-ndale-fushaten-per-delegjitimimin-e-pavaresise-se-kosoves/>

87 Koha Net, "Veseli propozon që taksa të pezullohet për 120 ditë", 28 janar 2019 në, <https://www.koha.net/arberi/142112/veseli-propozon-qe-taksa-te-pezullohet-per-120-dite/>

88 "Letra e Kryeministrit Haradinaj dërguar ambasadorëve të Quint-it dhe përfaqësueses së BE-së në Kosovë", 28 janar 2019 në, <https://kryeministri-ks.net/letra-e-kryeministrit-haradinaj-derguar-ambasadoreve-te-quint-it-dhe-perfaqesueses-se-be-se-ne-kosove/>

89 Intervistë e KDI-së me z.Zef Dedaj, Udhëheqës i Divizionit për Politika Tregtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, 21 prill 2020.

90 KDI kishte paraparë që një nga efektet pozitive të taksës do të ishte edhe rritja e konsumit të prodhimeve vendore. Shih publikimin "Taksa 100%: Vazhdim apo Pezullim", shkurt 2019 në <http://www.votaim.org/Public/Article?Dialog=true&Dialog=false&SelectedTab=Publications&SelectedMonthID=&SelectedYear=ëëpublications>

TABELA 1.4: Shkëmbimet tregtare Kosovë-Serbi gjatë periudhës 2014-2019

Marrëveshja  
për njohjen e  
certifikatave ADR

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Export</b>	27,292,000.00	32,262,000.00	41,331,000.00	48,246,000.00	33,529,000.00	27,361,000.00
<b>Import</b>	368,234,000.00	382,129,000.00	387,647,000.00	449,918,000.00	388,928,000.00	5,784,000.00

BURIMI: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Si rezultat, në periudhën janar-tetor 2019 sektori i prodhimit në Kosovë shënoi rritje të lehtë prej 10%.<sup>91</sup> Derisa tarifa pati ndikim pozitiv por jo shumë të theksuar në sektorin e prodhimit, efekti i saj ishte negativ në rritjen e çmimeve të produkteve nga kompanitë importuese, që si shkas kishin uljen e konkurrencës dhe koston e transportit.<sup>92</sup>

### 3.2 Rikthimi i reciprocitetit të plotë tregtar ndaj Serbisë

Presioni ndërkombëtar ndaj Kosovës për të larguar tarifën 100% ndaj Serbisë vazhdoi edhe ndaj Qeverisë së re LVV-LDK e udhëhequr nga kryeministri Kurti, e cila kishte trashëguar tarifën 100% nga ish Qeveria Haradinaj. Gjatë fushatës zgjedhore LVV dhe LDK ishin zotuar se do të largonin tarifën 100% ndaj Serbisë, për ta zëvendësuar atë me masa të reciprocitetit ndaj Serbisë. Lidhur me këtë çështje dy partitë ishin dakorduar edhe në programin e tyre qeverisës, negociatat rreth të cilit kishin zgjatur rreth katër muaj. Në kohën kur po paralajmërohej vendimi

për masa të reciprocitetit, përfaqësues të Odës Ekonomike të Kosovës kishin mbështetur vendimin duke kërkuar që ai të shoqërohej edhe me një varg kërkesash në raport me Serbinë. Kjo për arsye të numrit të madh të barrierave jo tarifore që Serbia kishte aplikuar tash e një kohë të gjatë ndaj Kosovës, gjatë eksportit dhe transitit në tregun e Serbisë.<sup>93</sup>

Mospajtimet e partnerëve të koalicionit rreth masave të reciprocitetit u shpërfaqën me anë të deklaratave kundërtënese të përfaqësuesve të lartë të LDK-së dhe LVV-së. Mospajtimet u bënë edhe më të thella kur presioni amerikan u bë edhe më i ashpër deri tek paralajmërimet në rrjetet sociale për të konsideruar tërheqjen e trupave amerikane nga Kosova<sup>94</sup> dhe pezullimin e disa fondeve për Kosovën.<sup>95</sup> Nëse dikur këto kërkesa kishin qenë vetëm për pezullim të tarifës për një kohë të caktuar, tanimë kërkesa ishte për heqje të tërësishme të kësaj mase, pa kushte dhe menjëherë.

I gjendur para presionit ndërkombëtar Kryeministri Kurti me datën 27 shkurt 2020 propozoi planin shtatë

91 Instituti GAP, "Ndikimi i taksës 100% në prodhim dhe çmime të produkteve në Kosovë: Periudha krahasuese: janar - tetor 2019 dhe janar - tetor 2018", mars 2020, fq.13 në, [https://www.institutigap.org/documents/41175\\_taksa100\\_\(SHQ\)%20Fn.pdf](https://www.institutigap.org/documents/41175_taksa100_(SHQ)%20Fn.pdf)

92 Instituti GAP, "Ndikimi i taksës 100% në prodhim dhe çmime të produkteve në Kosovë: Periudha krahasuese: janar - tetor 2019 dhe janar - tetor 2018", mars 2020, fq.13 në, [https://www.institutigap.org/documents/41175\\_taksa100\\_\(SHQ\)%20Fn.pdf](https://www.institutigap.org/documents/41175_taksa100_(SHQ)%20Fn.pdf)

93 Shih letrën e kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës Berat Rukiqi drejtuar Kryeministrit Kurti me datën 13 shkurt 2020 në, <https://telegafi.com/rukiqi-leter-te-hapur-kurtit-zevendesimi-taksës-te-shoqërohet-nje-varg-kerkesash-ndaj-serbisë/>

94 Shih deklaratat e disa senatorëve amerikan në profilet e tyre zyrtare në Twitter, <https://twitter.com/randpaul/status/1237547146414395392?lang=en>

95 "Deklarata e Korporatës Sfidat e Mijëvjeçarit në lidhje me statusin e programeve në Kosovë" (Në origjinal: "Statement of the Millennium Challenge Corporation Regarding the Status of Programs in Kosovo"), 13 mars 2020 në, <https://www.mcc.gov/news-and-events/release/stmt-031320-status-of-kosovo-programs>





Presioni ndërkombëtar ndaj Kosovës për të larguar tarifën **100%** ndaj Serbisë vazhdoi edhe ndaj Qeverisë së re **LVV-LDK** e udhëhequr nga kryeministri **Kurti**, e cila kishte trashëguar tarifën **100%** nga ish Qeveria **Haradinaj**.

pikësh për tarifën 100%, e cili parashihte fillimisht heqjen e tarifës për lëndën e parë dhe vendosjen graduale të masave të reciprocitetit varësisht nga ndryshimi i qasjes së Serbisë ndaj Kosovës dhe fushatës së saj të çnjohjeve.<sup>96</sup> Pas konferencës së kryeministrit Kurti ishin deklaruar edhe krerët e LDK-së të cilët kishin qëndrime tjera sa i përket këtij plani gjë që vërtetoi edhe një herë mungesën e dakordimit rreth kësaj çështje përbrenda koalicionit qeverisës.<sup>97</sup> Siç ishte planifikuar, me 20 mars në mbledhjen e Qeverisë u miratua vendimi për heqjen e tarifës 100% ndaj Serbisë për lëndën e parë.<sup>98</sup> Anëtarët e kabinetit qeverisës nga radhët e LDK-së nuk morën pjesë në votim ndërsa ata të Listës Serbe abstenuan.

Plani për zëvendësimin e tarifës me masa të reciprocitetit ndaj Serbisë vazhdoi të ndikonte në zhvillimet e brendshme në Kosovë edhe në periudhën kur vendi dhe bota po përballeshin me rrezikun e

përhapjes së pandemisë COVID 19. Mospajtimet që quan në shkarkimin e Ministrit të Punëve të Brendshme Agim Veliu nga Kryeministri Kurti, u konsideruan si shkas i nismës së LDK-së për iniciimin e mocionit të mosbesimit. LDK kishte paralajmëruar tashmë që një gjë e tillë do të ndodhte për shkak të qëndrimeve të kundërta rreth reciprocitetit. Mocioni u përkrah edhe nga subjektet opozitare dhe me 25 mars 2020 ky mocion u votua në Kuvend me 82 vota "për", 32 "kundër" dhe 1 abstenim.

Qeveria Kurti vazhdoi punën si Qeveri në detyrë, ndërsa me 1 prill ashtu siç ishte paralajmëruar, në mbledhjen e Qeverisë u miratua vendimi për zëvendësimin gradual të tarifës 100% ndaj Serbisë me masa të reciprocitetit.<sup>99</sup> Vendimi u mbështet vetëm nga anëtarët e kabinetit qeverisës nga radhët e VV-së. Me gjithë kundërshtimet e brendshme dhe të jashtme qeveria filloi zbatimin e masave të

96 "Kryeministri Kurti: Nga 15 mars 2020, hiqet tarifa për lëndën e parë që importohet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina", 27 shkurt 2020 në, <https://kryeministri-ks.net/kryeministri-kurti-nga-15-mars-2020-hiqet-tarifa-per-lenden-e-pare-qe-importohet-nga-serbia-dhe-bosnja-dhe-hercegovina/>

97 Shih deklaratat e kryetarit të LDK-së Isa Mustafa dhe ish zëvendëskryeministrit nga radhët e LDK-së Avdullah Hoti në profilet e tyre zyrtare në Facebook, rreth tarifës dhe masave të reciprocitetit.

98 "Qeveria e Kosovës merr vendim për të liru nga tarifa 100 për qind importin e lëndës së parë nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina", 20 mars 2020 në, <https://kryeministri-ks.net/qeveria-e-kosoves-merr-vendim-per-te-liruar-nga-tarifa-100-per-qind-importin-e-lendes-se-pare-nga-serbia-dhe-bosnje-hercegovina/>

99 Vendim i Qeverisë në detyrë "Për zbatimin gradual të reciprocitetit si parim në marrëdhëniet me Serbinë" Nr.01/20, 31 mars 2020 në, <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/04/Vendim-i-mbledhjes-s%C3%AB-20-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>



Nga data 1 prill kur janë vendosur masat e reciprocitetit e deri me 15 prill 2020, nga Serbia në Kosovë kanë hyrë mallra si lëndë e parë në vlerë prej **2,419,471.92 Euro** dhe mallra komerciale në vlerë prej **5,012,864.33 Euro**. Kurse, gjatë kësaj periudhe Kosova ka eksportuar mallra në vlerë prej **548,488.93 Euro**.

reciprocitetit nga data 1 prill 2020 në doganat e Kosovës.<sup>100</sup> Qysh në ditët e para u kthyen mbrapa disa kamionët me mallra nga Serbia të cilët nuk plotësonin dokumentacionin e nevojshëm kushtetues, siç parashihej në vendimin e Qeverisë. Nga data 1 prill kur janë vendosur masat e reciprocitetit e deri me 15 prill 2020, nga Serbia në Kosovë kanë hyrë mallra si lëndë e parë në vlerë prej 2,419,471.92 Euro dhe mallra komerciale në vlerë prej 5,012,864.33 Euro. Kurse, gjatë kësaj periudhe Kosova ka eksportuar mallra në vlerë prej 548,488.93 Euro.<sup>101</sup>

Në përgjithësi, sa i përket vendimit për reciprocitet ndaj Serbisë, vlen të theksohet se krahasuar me periudhat e kaluara kur Kosova ka vendosur masat e reciprocitetit ndaj këtij shteti në vitin 2011 dhe vitin 2015, kësaj radhe nuk gjeti përkrahje ndërkombëtare. Arsyeja për këtë mund të jenë dallimet përmbajtësore. Në vitin 2011 dhe 2015 masat e reciprocitetit ishin vendosur vetëm për një çështje të caktuar, konkretisht në vitin 2011 për ta shtyrë Serbinë për të njohur vulën doganore të Kosovës dhe në vitin 2015 për të njohur certifikatën ADR të Kosovës. Ndërsa, masat e reciprocitetit të vendosura këtë vit përfshijnë një gamë të çështjeve

me synimin për të arritur reciprocitet të plotë politik e tregtar me Serbinë.<sup>102</sup> Pavarësisht se këto masa në parim janë të drejta, kundërshtimet ndërkombëtare ndërlidhen me refuzimin e Serbisë për tu rikthyer në procesin e dialogut derisa Kosova të largojë çdo masë tregtare. Këto rrethana e shtyen Qeverinë e re të udhëhequr nga Avdullah Hoti, që të shfuqizonte masat e reciprocitetit për ti dhënë mundësi vazhdimit të procesit të dialogut.

Rikthimi i qeverisë Kurti II në mars të vitit 2021, nuk pasoi me rikthim të masave të reciprocitetit tregtar ndaj Serbisë edhe pse një gjë e tillë ishte paralajmëruar. Në anën tjetër, me 8 tetor 2021, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka marrë dy vendime për vendosjen e masave dumping ndaj Serbisë në importin e bllokave dhe të koncentratit për shpezë dhe kafshë. Ministrja Rozeta Hajdari që udhëheq me këtë ministri, është deklaruar për mundësinë e reciprocitetit të plotë me Serbinë, mirëpo një vendim i tillë ende nuk është ndërmarrë.

100 Intervistë e ushtruesit të detyrës së drejtorit të Doganës së Kosovës Ibrahim Xhaka, 1 prill 2020 <https://kallxo.com/lajm/u-d-drejtori-i-doganes-jep-detaje-per-zbatimin-e-reciprocitetit/>

101 Intervistë e KDI-së me z.Zef Dedaj, Udhëheqës i Divizionit për Politika Tregtare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, 21 prill 2020.

102 Intervistë e KDI-së me një ish përfaqësues të Kosovës në dialogun me Serbinë, 5 maj 2020.

## Përfundim

Barrierat tregtare si masa politike kanë karakterizuar në masë të madhe marrëdhëniet tregtare mes Kosovës dhe Serbisë. Serbia filloi aplikimin e barrierave tregtare ndaj Kosovës, pas ndryshimit të statusit të Kosovës nga shtet i administruar nga UNMIK-u, në shtet të pavarur, sepse pavarësia e Kosovës implikoi ndryshime të shumta në dokumentet zyrtare të Kosovës duke përfshirë edhe ato tregtare. Serbia refuzoi të njëjtte realitetin e ri fillimisht duke vendosur embargo tregtare e më pas edhe një sërë të barrierave jo tarifore, duke përfshirë mosnjohjen e dokumenteve dhe pengesave në inspektim dhe transport të mallrave.

Kosova nuk ndërmori ndonjë hap për të iu përgjigjur bllokadës tregtare të Serbisë deri në vitin 2011 kur vendosi masat e reciprocitetit, disa muaj pas fillimit të dialogut teknik në Bruksel. Arsyeja për vendosjen e këtyre masave ishte refuzimi i Serbisë për të njohur vulën doganore të Kosovës. Këto masa zgjatën deri në arritjen e marrëveshjes për vulat doganore e cila zhblokoi sërish shkëmbimet tregtare mes dy vendeve. Megjithatë, Serbia sërish shkeli marrëveshjen duke përdorur vula paralele dhe duke vendosur barriera jo tarifore ndaj Kosovës. Në këtë drejtim përderisa Kosova përdori barrierat tregtare për të konsoliduar shtetësinë e saj dhe për të vendosur një marrëdhënie të barabartë me Serbinë, kjo e fundit aplikonte barriera për të rezistuar dhe kundërshtuar shtetësinë e Kosovës.

Aplikimi i barrierave reciproke vazhdoi përgjatë viteve pavarësisht se mes palëve po zhvillohej dialogu

për normalizimin e marrëdhënieve. Në kuadër të këtij procesi u rregulluan aspekte të ndryshme të marrëdhënieve tregtare me anë të marrëveshjeve për lëvizjen e lirë, menaxhimin e integruar të kufirit (IBM), mbledhjen e të hyrave doganore etj. Ajo që i karakterizoi këto marrëveshje ishte përmbajtja dhe modalitetet e operimit të cilat përcaktuan zhvillimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi pa njohje reciproke.

Vazhdimi i qasjes bllokuese të Serbisë në shkëmbimet tregtare detyroi Kosovën që të rikthente masat e reciprocitetit për herë të dytë në vitin 2015. Kjo për shkak të mosnjohjes nga Serbia së certifikatave ADR të Kosovës për mallërat e rrezikshme. Edhe kësaj radhe masat e reciprocitetit kishin rezultuar të suksesshme për të detyruar Serbinë që të njëjtte këto certifikata me anë të marrëveshjes përkatëse e arritur në kuadër të dialogut.

Edhe pse Serbia sërish kishte vazhduar me aplikimin e barrierave jo tarifore ndaj kompanive importuese të Kosovës, kjo e fundit nuk i ishte kundërpërgjigjur më me masa tregtare deri në vitin 2018, kur kishte vendosur tarifë fillimisht 10% e më pas 100% në importet nga Serbia. Mirëpo, barrierat tregtare nga ana e Serbisë edhe pse ishin në listën e arsytiveve për vendosjen e tarifës, në fakt aplikimi i kësaj mase kishte arsye tjera. Tarifa u vendosë pas fushatës së Serbisë e cila pamundësoi anëtarësimin e Kosovës në organizatën INTERPOL. Në fund, ishte pengimi i idesë kontraverse të korrigjimit të kufijve e cila rezultoi të ishte arsyeja e vërtetë për vendosjen e kësaj mase ndaj Serbisë.

Ndërrimi i qeverive në Kosovë, shfuqizoi tarifën për të zëvendësuar atë me masa të reciprocitetit të plotë tregtar ndaj Serbisë. Mirëpo ashtu si tarifa as reciprociteti nuk gjetën mbështetje të gjerë as përbrenda vendit dhe as nga partnerët ndërkombëtar. Këta të fundit dërguan kërkesa të njëpasnjëshme në adresë të qeverisë së Kosovës duke kërkuar largimin e menjëhershëm të të gjitha masave tregtare të cilat sipas tyre po pengonin vazhdimin e procesit të dialogut.

Si përfundim dy qeveri në Kosovë ranë për shkak të refuzimit për të pezulluar masat tregtare ndaj Serbisë, dhe mungesës së përkrahjes së brendshme dhe të jashtme për të mbajtur në fuqi këto masa. Në këtë drejtim, procesi i dialogut si proces i rëndësishëm rajonale dhe ndërkombëtare për përfaqësuesit ndërkombëtarë, mbizotëroi kërkesën e drejtë të Kosovës për të vendosur një raport të barabartë me Serbinë. Mungesa e përkrahjes së jashtme nga partnerët ndërkombëtar ndikoi në qëndrimet dhe mungesën e përkrahjes së brendshme nga spektri politik, sepse shumica e liderëve politik dhe partive politike në vend kishin si prioritet ruajtjen e marrëdhënieve me partnerët ndërkombëtar, të cilët vazhdimisht bënë thirrje për të larguar çdo pengesë për vazhdimin e dialogut.



Kosova Democratic Institute  
Bajram Kelmendi N/45  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel/Fax: +381(0)38 248 038  
[info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)



Konrad-Adenauer-Stiftung  
Bulevardi Nënë Tereza, 27/3-6  
10000 Prishtinë  
Tel: +383(0)38 229 874  
[www.kas.de/kosovo](http://www.kas.de/kosovo)